

Spiecapag Shqipëria Degë e Shoqërise së huaj
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5 – 21

Spiecapag Shqipëria
Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016
AKTIVE		
Aktivitet afatgjata		
Aktivitet afatgjata materiale	5	1,396,939,192
Totali i aktiveve afatgjata		1,396,939,192
Aktivitet afatshkurtra		
Inventarë	6	679,444,069
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	23	4,037,971,410
Llogari të arkëtueshme të tjera	7	455,769,162
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	8	41,252,589
Mjetet monetare në arkë dhe në bankë	9	12,351,298,250
Totali i aktiveve afatshkurtra		17,565,735,480
Totali i aktiveve		18,962,674,672
KAPITALI		
Kapitali themeltar		-
Fitime të mbartura		-
Fitimi i ushtrimit		1,559,343,984
Totali i kapitalit	10	1,559,343,984
DETYRIMET		
Detyrime afatgjata		
Finacime nga mëma	11	184,862,253
Totali i detyrimeve afatgjata		184,862,253
Detyrime afatshkurtra		
Llogari të pagueshme tregtare	12	990,225,811
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	23	8,470,724,906
Parapagimet e arkëtuara	13	7,469,705,465
Detyrime tatimore	14	287,812,253
Totali i detyrimeve afatshkurtra		17,218,468,435
Totali i detyrimeve		17,403,330,688
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		18,962,674,672

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Spiecapag Shqipëria
Pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	15,036,051,650
Të ardhura të tjera		-
Total të ardhura		15,036,051,650
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	16	(12,526,382,064)
Shpenzime personeli	17	(199,994,427)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	18	(31,999,293)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	19	(252,054,887)
Total shpenzime		(13,010,430,671)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	20	41,234
Shpenzime të tjera financiare (neto)	21	(182,251,177)
Fitimi/humbja para tatimit		1,843,411,036
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	(284,067,052)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(284,067,052)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-
Fitimi/humbja e vitit		1,559,343,984
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		1,559,343,984

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Spiecapag Shqipëria
Pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	-	-	-	-	-	-
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					1,559,343,984	1,559,343,984
Transferim në fitime të mbartura					-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:					-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	-	-	-	-	1,559,343,984	1,559,343,984

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratorët e Spiecapag Shqipëria më _____ dhe janë firmosur si më poshtë.



Z. Eric Eros Azika
Përgjegjës i Departamentit të Kontabilitetit



Z. Guillaume Batut
Administrator



Spiecapag Shqipëria
Pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit		1,843,411,036
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi		31,999,293
Zhvlerësimi		
Tatimi mbi fitimin		
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Rënie/(rritje) në inventar		(679,444,069)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera		(4,493,740,572)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera		9,464,695,918
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra		(41,252,589)
Ndryshimi ne te ardhura te shtyra		7,469,705,465
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		13,595,374,482
Interesa të paguara		-
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit		-
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		(1,428,938,485)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		
Blerje e shoqërisë së kontrolluar minus paratë e arkëtuara		
Investime të tjera afatgjata		
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues		(1,428,938,485)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata		184,862,253
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër		
Shtesa/pakësime në qera financiare		
Dividendë të paguar		
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues		184,862,253
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		12,351,298,250
Mjetet monetare në fillim të periudhës		-
Mjetet monetare në fund të periudhës	9	12,351,298,250

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Spiecapag Shqipëria me formë ligjore Degë e Shoqërisë së huaj është regjistruar më 08/12/2015 në bazë të ligjit “Për shoqëritë tregtare” dhe statuti i saj. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj dhe ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Objektet kryesore të veprimtarisë së shoqërisë janë dizenjo, inxhinieri dhe ndërtim, asistencë teknike për impiante dhe makineri të rënda, ndërtimi dhe mirëmbajtje e impianteve përkohësisht përfshirë shërbime në terren. Shoqëria kryen çdo lloj transporti në Shqipëri, si edhe çdo aktivitet tjetër për nevojat e transportit apo nevoja të tjera në kuadër të Projektit TAP.

Administratorë të Shoqërisë janë Z. Guillaume Batut dhe Z. Olivier Thierry Marie Balloy. Adresa e Shoqërisë është Rr. “Ibrahim Rugova”, nr.5, Sky Tower, 13/4, 1000 Tiranë dhe është e regjistruar si person juridik në Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj me L61402015T.

Në 31 dhjetor 2016 shoqëria ka patur 22 punonjës.

2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme aplikohen në periudhat e raportimit financiar që fillojnë me ose pas datës 1 janar 2016.

- Ndryshimet në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 - Njësitë investuese: Aplikimi i përjashtim të konsolidimit (publikuar ne dhjetor 2014 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në SNRF 11”Marrëveshjet e përbashkëta” Kontabiliteti për Blerjet e interesave në operacione të përbashkëta - (publikuar në maj të 2014 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).
- SNRF 14 “Llogaritë e shtyra për arsye rregullatore” (publikuar ne janar 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më 1 janar 2016)
- Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja Fillestare (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 - Sqarimi i metodave të pranueshme të Zhvlerësimi dhe Amortizimi (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 “Bujqësia: Bimët Bartëse”- (publikuar në qershor 2014 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 shkurt 2016)
- Ndryshimet në SNK 27 - Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta (publikuar në gusht 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)

2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emetuar por nuk janë ende efektive:

- SNRF 9 “Instrumentat Financiar” (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- SNRF 15 “Të ardhurat nga Kontratat me Klientët” dhe amendime të mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- SNRF 16 “Qiratë” (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019)
- Ndryshimet në SNRF 2 “Pagesat e bazuara në aksione” (Klasifikimi dhe matja e pagesës të bazuar në aksione (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4 “Kontratat e Sigurimit”- Aplikimi i SNRF 9 “Instrumentat Financiar” me SNRF 4 “Kontratat e Sigurimit” (efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose kur SNRF 9 “Instrumentat Financiare aplikohet për herë të pare).
- Ndryshimet në SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” dhe SNK 28 “Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta”- Shitja ose Kontributi asetëve ndërmjet një investitori dhe ortakut ose sipërmarrjet e përbashkëta dhe ndryshime të mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- Ndryshimet në SNK 7 “Pasqyra e Flukseve Monetare” - Paraqitja fillestare (efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Janari 2017)
- Ndryshimet në SNK 12 “Tatimi mbi të ardhurat”- Njohja e detyrimeve tatimore të shtyrë për humbjet e porealizuara (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2017)
- Ndryshimet në SNK 40 “Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara”- Transferimet e aktiveve afatgjata materiale të investuara (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- Ndryshime të standardeve të ndryshme “Përmirësime të SNRF-ve (cikli 2014-2016)” që rrjedhin nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12, IAS 28) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (Ndryshimet në SNRF 12 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017 dhe ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018)
- SIC 22 “Transaksionet në monedhë të huaj dhe parapagimet” (për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Shoqëria ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

(Vlerat janë në Lek)

3. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

3.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

3.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
EUR/Lek	135.23	137.28
USD/ Lek	128.17	125.79

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

(Vlerat janë në Lek)

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së koston së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)**4.4 Aktive afatgjata materiale***i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa dhe instalime	Vlera e mbetur	5 %
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mobilje e orendi	Vlera e mbetur	20 %

Këto norma reflektojnë më së shumti vlerën e pritshme të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike që burojnë nga aktivet afatgjata materiale. Prodhimi në proces nuk amortizohet.

Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

4.7. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4.8. Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësia ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.9. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i Shoqërisë dhe Manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.10. Provizione

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.11. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Spiecapag Shqipëria

Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

5. Aktive Afatgjata Materiale

Aktivitet Afatgjata Materiale më 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Mobilje e pajisje zyre	Ne proçes	Totali
Kosto							
Gjendja më 1 janar 2015							-
Shtesa							-
Transferime							-
Pakësime							-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	-	-	-	-	-	-
Shtesa	111,530,610	312,602,264	497,838,419	22,676,367	11,985,448	472,305,377	1,428,938,485
Transferime							-
Pakësime							-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	111,530,610	312,602,264	497,838,419	22,676,367	11,985,448	472,305,377	1,428,938,485
Zhvlërësimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2015							-
Amortizimi i vitit							-
Kthim amortizimi							-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	1,867,082	9,124,813	17,417,772	2,431,899	1,157,727		31,999,293
Pakësime							-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,867,082	9,124,813	17,417,772	2,431,899	1,157,727	-	31,999,293
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	109,663,528	303,477,451	480,420,647	20,244,468	10,827,721	472,305,377	1,396,939,192

Spiecapag Shqipëria
Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

6. Inventarë

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2016 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>
Lëndë ndihmëse dhe të konsumueshme	366,129,116
Punime në proces të pa certifikuara	313,314,953
	<u>679,444,069</u>

7. Llogari të arkëtueshme të tjera

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>
TVSH e kreditueshme	387,591,774
TVSH për t'u regulluar	65,548,042
Të arkëtueshme nga dogana	444,705
Garanci të paguara	1,154,245
Të tjera të arkëtueshme	1,030,396
	<u>455,769,162</u>

8. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime të shtyra për prime sigurimi	41,252,589
	<u>41,252,589</u>

9. Mjete monetare në arkë dhe në bankë

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2016</u>
Likuiditete në bankë	12,340,221,868
Likuiditete në arkë	11,076,382
	<u>12,351,298,250</u>

10. Kapitali

Shoqëria është degë e një shoqërie të huaj dhe nuk ka kapital të regjistruar.

Fitimi i ushtrimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 është: 1,559,343,984

Shoqëria nuk ka fitime të mbartura.

Spiecapag Shqipëria
Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

11. Hua afatgjata nga mëma

Huatë afatgjata nga ortaku detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2016</u>
Financime nga SC France	184,862,253
	<u>184,862,253</u>

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari të pagueshme tregtare	990,225,811
	<u>990,225,811</u>

13. Parapagime të arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara më 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>
Parapagime nga klientë	7,008,931,815
Të ardhura të shtyra	460,773,650
	<u>7,469,705,465</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	850,471
Detyrime për tatim page	2,023,985
Detyrime për tatim në burim	870,745
Detyrim tatim fitimi	284,067,052
	<u>287,812,253</u>

Spiecapag Shqipëria
Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit më 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15,036,051,650
	15,036,051,650
Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:	
	31 dhjetor 2016
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	26,354,857,500
Zbriten parapagimet dhe të ardhurat e shtyra	(7,469,705,465)
Zbriten Autofaturimet 2016	(3,740,597,641)
Zbriten eksportet për qëllim të kthimit të pjesëve dhe pajisjeve	(108,502,744)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	15,036,051,650
Sipas Kontabilitetit	15,036,051,650
Diferenca	-
Të ardhura nga këmbimet valutore	346,712,899
Të ardhura nga interesat	41,234
Total të ardhura deklaruar në FDP-në e Tatim Fitimit	15,382,805,783

16. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Materiale ndihmëse dhe të konsumueshme	764,983,502
Lëndë djegëse	71,111,747
Pjesë këmbimi	316,569,159
Qera pajisje	2,143,718,975
Qera kampi	204,085,221
Nënkontraktorë	7,702,166,710
Shërbime teknike dhe të manaxhimit	939,494,842
Mirëmbajtje dhe riparime	24,580,407
Transport	359,671,501
	12,526,382,064

Spiecapag Shqipëria
Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

17. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për paga	190,715,244
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	9,279,183
	199,994,427

18. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime amortizimi	31,999,293
	31,999,293

19. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Blerje energji,ujë	4,782,224
Mirëmbajtje dhe riparime	11,486,459
Sigurime	29,653,659
Udhëtime e dieta	44,610,097
Shpenzime për garanci	44,639,734
Qera zyra	14,687,202
Shpenzime ligjore e konsulenca	11,931,913
Shpenzime të ndryshme administrative	3,619,218
Shpenzime për zyrat	10,491,726
Shpenzime telefonie dhe interneti	9,868,775
Komisione dhe tarifa bankare	3,408,366
Tatime dhe taksa	27,555,180
Gjoha dhe dëmshpërblime	652,470
Shpenzime për pritje	211,452
Sponsorizime e donacione	1,303,375
Të tjera shpenzime për personelin	26,230,902
Të tjera shpenzime	6,922,135
	252,054,887

Spiecapag Shqipëria
Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

20. Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)

Shpenzimet e interesit (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat	41,234
	41,234

21. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Shpenzimet e tjera financiare (neto) paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Humbje nga këmbimet valutore	(528,964,076)
Të ardhura nga këmbimet valutore	346,712,899
	(182,251,177)

22. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2016
Fitimi para tatimit	1,843,411,036
Total shpenzime të panjohura	50,369,309
Shpenzime udhëtimi	42,794,704
Gjoba dhe penalitete	652,470
Shpenzime pa dokumenta të regullta tatimore	6,922,135
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	1,893,780,345
Humbje fiskale e mbartur	-
Tatim fitimi @15%	284,067,052
Fitimi Neto	1,559,343,984

23. Palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme me palët e lidhura paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2016	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Spiecapag France	-	3,789,970,595
Spiecapag Transadriatica	4,037,971,410	4,865,616,564
	4,037,971,410	8,655,587,159

Spiecapag Shqipëria
Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

23. Palët e lidhura (vazhdim)

Transaksionet me palët e lidhura paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2016	
	Shitje	Blerje
Spiecapag France	-	5,244,569,565
Spiecapag Transadriatica	3,307,272,391	5,996,327,240
	3,307,272,391	11,240,896,805

24. Manaxhimi i riskut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi prej saj i instrumentave financiarë:

- risku i kreditit
- risku i likuiditetit
- risku i monedhës

Ky shënim paraqet informacionin rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej risqeve të mësipërme, objektivave të Shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe manaximin e riskut dhe manaximin e kapitalit të Shoqërisë. Shënime sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Drejtimi ka përgjegjësinë e plotë për hartimin dhe mbikqyrjen e kuadrit të manaximit të riskut të shoqërisë. Politikat e manaximit të riskut të Shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar risqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kontrollet dhe limitet e duhura të riskut dhe për të monitoruar riskun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaximit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve e procedurave të manaximit të saj, ka si qëllim të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni me rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentat kryesorë financiarë të Shoqërisë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

(a) Risku i kreditit

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson shumën maksimale të ekspozimit të rrezikut. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit. Shoqëria ndjek të drejtat e paarkëtuara në baza periodike.

	31 dhjetor 2016				Total
	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	
Llogari të arkëtueshme tregtare	3,956,479,669	-	-	-	3,956,479,669
Llogari të arkëtueshme të tjera	537,260,903	-	-	-	537,260,903
Mjete monetare	12,351,298,250	-	-	-	12,351,298,250
	16,845,038,822	-	-	-	16,845,038,822

Spiecapag Shqipëria
Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

24. Manaxhimi i riskut financiar (Vazhdim)

(b) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria të hasë ndonjë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare që likuidohen nëpërmjet parave apo aktiveve të tjera financiare.

Më poshtë paraqiten aktivet dhe pasivet financiare sipas maturitetit kontraktual të tyre më 31 dhjetor 2016.

	31 dhjetor 2016				Total
	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	4,493,740,572	-	-	-	4,493,740,572
Mjete monetare në arkë dhe bankë	12,351,298,250	-	-	-	12,351,298,250
Totali	16,845,038,822	-	-	-	16,845,038,822
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(9,748,762,970)	-	-	-	(9,748,762,970)
Hua	-	-	(184,862,253)	-	(184,862,253)
Totali	(9,748,762,970)	-	(184,862,253)	-	(9,933,625,223)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2016	7,096,275,852	-	(184,862,253)	-	6,911,413,599

(c) Risku i valutës

Ekspozimi ndaj riskut të valutës

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2016 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2016					Total
	EUR	USD	LEK	CHF	Të tjera	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	3,957,593,906	-	536,146,666	-	-	4,493,740,572
Mjete monetare në arkë dhe bankë	12,342,721,765	-	8,576,485	-	-	12,351,298,250
Totali	16,300,315,671	-	544,723,151	-	-	16,845,038,822
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(8,981,251,232)	-	(767,511,738)	-	-	(9,748,762,970)
Hua	(184,862,253)	-	-	-	-	(184,862,253)
Totali	(9,166,113,485)	-	(767,511,738)	-	-	(9,933,625,223)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2016	7,134,202,186	-	(222,788,587)	-	-	6,911,413,599

24. Manaxhimi i riskut financiar (Vazhdim)

(d) Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përfaqëson riskun që vlera e instrumentave financiare do të luhetet nga ndryshimet në treg të normës së interesit dhe riskun që maturiteti i aktiveve financiare që mbartin interes të jetë i ndryshëm nga maturiteti i pasiveve financiare që mbartin interes. Gjatësia e kohës në të cilën norma e interesit është fikse për një instrument financiar përcaktohet se në ç'masë është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Aktivitetet dhe detyrimet e Shoqërisë mbajnë normat e interesit të tregut. Nuk ka instrumenta financiarë të cilat mbartin norma të interesit.

25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.